



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 16 Dt. 13.02.2017

“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “FATJONI” SH.P.K

- Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pikës 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim të subjektit “FATJONI” shpk, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore,Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “FATJONI”shpk, me administrator **Z.Bashkim GJOKA**, për përdorim të burimit ujor **përroi i Fshatit**, degë e Lumit të Bushtricës, degë e lumit Drin i Zi,për prodhim energjie elektrike. Sipas studimit të paraqitur nga subjekti **HEC**

TERFOJE do të ketë këto të dhëna:

Vendndodhja: Fshati Fshat, Njësia Administrative Gryk-Çajë, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Vepra e marrjes Nr1(përroi i Madh): $X_1 - 44\ 54\ 960$; $Y_1 - 46\ 43\ 000$; $Z_1 - +1160\ m$

Vepra e marrjes Nr.2(përroi i Buzëmardhes); $X_2 - 44\ 55\ 720$; $Y_2 - 46\ 43\ 300$; $Z_2 - +1154m$

Koordinatat e godinës së centrali: $X - 44\ 54\ 440$; $Y - 46\ 41\ 750$; $Z - +900\ m$;

Koordinatat e pikës së shkarkimit : $X - 44\ 54\ 440$; $Y - 46\ 41\ 750$; $Z - +900\ m$;

Prurja mesatare vjetore e burimit : $Q_1\ mes = 0.126\ m^3/sek$; $Q_2\ mes = 0.605\ m^3/sek$

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: $Q_1\ llog = 0.15\ m^3/sek$; $Q_2\ llog = 0.73\ m^3/sek$;

Prurja ekologjike: $Q_{ekol} = 0.03\ m^3/sek$; $Q_{ekol} = 0.13\ m^3/sek$;

Prurja që shkarkohet: $0.88\ m^3/sek$.

2- Autorizimi i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Sekretari
Martin PLLUMBI

Kryetar
Paulin RADOVANI